

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Ekspert “Senior Full Stack Developer” – A (Ekspert Zhvillues i Lartë i Platformës së plotë Full Stack-A)	Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes	Tiranë	Pa afat	Po	Po	16.07.2025	30.07.2025

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Ekspert “Senior Full Stack Developer”-A (Ekspert Zhvillues me përvojë të lartë i Platformës së plotë Full Stack-A), në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 16.07.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 30.07.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës, Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al\(linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit\)](http://www.mod.gov.al/linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Ekspert “Senior Full Stack Developer” –A (Zhvillues me përvojë të lartë i Platformës së plotë Full Stack-A)
- b. Arsimimi: “Diplomë “Master Shkencor” në fushat teknologji informacioni, informatikë, inxhinieri telekomunikacioni, inxhinieri informatike/softweri, inxhinieri elektronike, shkenca kompjuterike, sisteme informacioni ose fusha të ngjashme me to.
- c. Kualifikimi: **Backend Development:** Node.js, Express.js, Python (Django/Flask), RESTful API design, GraphQL
Frontend Development: React, Vue.js, Angular, JavaScript (ES6+), TypeScript, HTML5, CSS3
Menaxhimi i databasave: SQL (PostgreSQL, MySQL), NoSQL (MongoDB, Redis), optimizimi i kuerive “query”
Version Control: Git, GitHub/GitLab workflows, CI/CD pipelines

Menaxhimi i serverave: Linux/Windows administrim serveri, Docker, proceset e instalimit

- d. Trajnimi: Trajnime të ndryshme në fushën relevante të pozicionit të punës.
- e. Eksperienca në Punë: Minimum 5 vjet përvojë në fushën e zhvillimit të software-ve
- f. Gjuha e huaj: Anglisht
- g. Kërkesa të tjera specifike: Të ketë realizuar (portofolio) me projekte komplekse të aplikacioneve të web-it. Përvojë me instalimin dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve në prodhim.
Përvojë me metodologjitë “Agile” dhe mjetet për menaxhimin e projekteve
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Të plotësojë kriteret për tu pajisur me Çertifikatë të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015. Çertifikatë Sigurie “Secret”.

Përshkrimi i punës:

Ekspert “Senior Full Stack Developer”-A (Ekspert Zhvillues i Lartë i Platformës së plotë Full Stack-A) me përvojë për të zhvilluar aplikacione web komplekse dhe të integruara. Kandidati do të jetë përgjegjës për zhvillimin end-to-end të sistemeve, arkitekturën e projekteve dhe implementimin e zgjidhjeve inovative.

Detyrat kryesore:

- Zhvillimi i aplikacioneve full-stack nga fillimi në fund
- Dizajnimi, optimizimi dhe mirëmbajtja e databazave
- Zhvillimin e API (ndërfaqes së aplikacionit) dhe integrimi me sisteme të jashtme
- Zhvillimin “Front-end” me frameworks moderne
- Rishikimi i kodeve dhe sigurimi i cilësisë “quality assurance”
- Optimizim të performancës dhe identifikimin e problematikave “troubleshooting”
- Implementimi i praktikave më të mira për sigurinë dhe shkallëzueshmërinë “scalability”
- Kryen detyra të tjera përkatëse sipas kërkesave të eprorit brenda fushës së përgjegjësisë

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.